



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISË



Programi: **Master**

Drejtimi: **Histori**

Lënda: SHKRIM AKADEMIK I AVANCUAR

<i>Pedagogu:</i>	Prof. Dr. Valentina Duka;
<i>Ngarkesa:</i>	6ETCS (15 javë 2 leksione 1 seminare në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	bazë
<i>Viti/Semestri:</i>	II/II

Përshkrimi:Lënda Shkrimi Akademik synon që t'u japë studentëve njohuritë themelore mbi mënyrat dhe metodat e shkrimit të një punimi të thelluar akademik sikundër është dizertacioni i Masterit. Gjatë zhvillimi të kësaj lënde studentët do të njihen me proceset që ndiqen për të kryer punën kërkimore, llojet e burimeve që përdoren në punën kërkimore si dhe me rrugët që ndiqen për të mbledhur materialin e nevojshëm që shërben në shkrimin e punimeve akademike. Studentët do të përvetësojnë gjithashtu edhe metodat e analizimit dhe leximit të burimeve primare dhe sekondare në mënyrë që t'i përdorin ato sa më mirë gjatë shkrimit të disertacionit. Procesi pedagogjiko-akademik do të vazhdojë me parashtrimin e llojeve të ndryshme të punimeve dhe me kriteret që përcaktojnë ndarjen e tyre. Studentëve do tu mësohet procesi i shkrimit të një punimi me fokus disertacionin dhe fazat nëpër të cilat ai kalon. Studentëve do tu mësohet si të citojnë si dhe mënyrat për të evituar plagjiaturën, referencat dhe bibliografinë. Në qëndër të këtij kursi do të jetë pajisja e studentëve me mjetet e duhura për të përballuar me sukses të gjitha kërkesat e studimeve universitare dhe të mësojnë të shprehin qartë dhe në mënyrë të organizuar mendimet e tyre, si dhe të nxisë tek ata mendimin kritik dhe gjykimin shkencor.

Temat e leksioneve:

1. Paraqitja e lëndës. Çfarë është shkrimi akademik.
2. Burimet e para. Çfarë janë ato, rëndësia dhe përdorimi i tyre.
3. Analiza e burimeve të para dhe kriteret e vlerësimit të tyre.
4. Arkivi, katalogu i fondeve dhe kërkimi i burimeve të para.
5. Burimet e dyta. Çfarë janë ato, rëndësia dhe përdorimi i tyre..
6. Analiza e burimeve të dyta dhe marrëdhënia tekst–autor.
7. Katalogjet dhe puna kërkimore në bibliotekë.
8. Fondet burimore të institutve shkencore.
9. Përdorimi i shtypit. Rëndësia dhe kufizimet e tij.
10. Citimi dhe perifraximi.

11. Hartimi i strukturës paraprake.
12. Shkrimi i 'Parathënies.'
13. Shkrimi i 'Hyrjes.'
14. Trupi i punimit dhe argumenti kryesor.
15. Rishikimi i punimit dhe përmbledhja e 'Përfundimeve.'

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI: 70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

20 % e notës përfundimtare

KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

40 % e notës përfundimtare

Literatura e detyrueshme për studentin:

1. Duka, Valentina. *Shkrimi Akademik për studentët e lëndëve historike.* (Leskion i pabotuar).
2. Eco, Umberto. *Si të shkruajmë një punim diplome.* (Tiranë: Dituria, 2005).

Literatura plotësuese

1. Zeneli, Bernard. *Shkrimi Akademik.* (Tiranë: UFO, 2006).
2. Musai, Bardhyl. *Të shkruajmë ese.* (Tiranë: Pegi, 2004).
3. Nishku, Majlinda. *Proçesi dhe shkrimet funksionale.* (Tiranë: Pegi, 2004).

MIRATOI

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. Asoc.dr. EvaTafili